

# RILINDASI

Viti IV - Nr:53

E diel, 28 dhjetor 2014

Kryeredaktore: Admirina PEÇI




## DORËSHKRIMI I PANJOHUR

### Zbulohet në Dubrovnik studimi i Gjon Gazulit për astronominë

NGA **DR.ETLEVA LALA**  
**DR. MUSA AHMETI**

Studiues të shumtë janë marrë me studimet për origjinën, kulturën, traditën, gjuhën, religjionin dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me shqiptarët dhe trojet e tyre etnike. Thellësia dhe serioziteti i këtyre studimeve, në disa raste, edhe sot e kësaj dite është i patejkaluar dhe një nga pikat më të refuara në fushën e albanologjisë, burimologjisë dhe historisë kombëtare shqiptare. Debatet e shumta të mirfillta me bazë shkencore, botimet e korpuseve të dokumenteve, analizat studimore dhe librat e shumtë, të botuar që nga zbulimi i shtypshkronjës së Gutenbergut e deri sot, janë një nga dëshmit më të forta, për një interes të veçantë që kishin të huajt, për popullin shqiptar, fatin dhe rolin e tij gjatë furtunës shekullore mesjetare, por edhe gjatë zhvillimeve të vullshme të rilindjes dhe të iluminizmit evropian dhe atij shqiptar.

Nuk mbeten prapa botimeve të shumta dhe voluminoze as dorëshkrimet e shumta të autorëve të ndryshëm apo ato anonime, që për temë bosht kishin popullin shqiptar dhe trojet etnike të tij. Zbulimet e këtyre dorëshkrimeve, janë një thesar i vërtetë, ngase pasurojnë shumë herë zbrazëtitrat e krijuara në epoka të caktuara



Gjon Gazuli

kohore ose plotësojnë e saktësojnë njohuritë që kemi deri tani për ngjarje, personalitete dhe data të rëndësishme historike.

Arkivi Historik i Dubrovnikut, në Dubrovnik krahas Bibliotekës dhe Arkivit të Vëllëzërve të Vegjël-Minoritë [Male Braće], Bibliotekës dhe Arkivit të Domenikanëve, Bibliotekës Shkencore të Dubrovnikut, Bibliotekës e Arkivit të Jezuitëve etj., ruan shumë dorëshkrime me vlera të veçanta për Shqipërinë dhe shqiptarët, të cilat deri me sot nuk janë botuar. Në fonde të ndryshme të këtij Arkivi, kemi arritur të konsultojmë autorë të njohur, por edhe anonim, një numër të konsideruar dorëshkrimesh nga shekuj të ndryshëm, vlera e të cilave është tepër e çmuar.

Raguza në mesjetë ishte njëra ndër qendrat kryesore të shkencës dhe kulturës europiane në përgjithësi, ndërsa kishte primatin në shkencat ekzakte: matematikë e astronomi. Një kontribut të veçantë për një gjendje të tillë ka dhënë edhe humanisti shqiptar, Gjon Gazuli. Dorëshkrimet e tij autografë, janë të rralla, të shpërdara nëpër biblioteka e arkiva europiane, po kanë një vlerë shumë rëndësishme për të kuptuar dhe ndjekur rolin dhe vendin që kishte astronomia në Raguzë dhe në Europë. Në këtë drejtim, vend parësor ka dorëshkrimi autograf, i Gjon Gazulit nga Arkivi Historik i Dubrovnikut, në Dubrovnik, që sot ruhet në signaturën: Fondi: Bassegli-Gozze, Rukopisi, nr. 32, f. 271-281....

vijon në faqen 18-19

### ‘Ata hyjnë pa trokitur’ persiatje për një komedi dramatike

Si duhet të refuzohet çdo model diktature si ajo që lamë pas, ashtu edhe neodiktatura e sotme, e cila në forma të ndryshme e të kamufluara, autoritetin e Njëshit po e ngre në kult...

NGA **MEXHIT PRENÇI**

A të që zakonisht thuhet në fund pas një analize kritike, po e artikuloj në film: komedia dramatike e Armado Borës “Ata hyjnë pa trokitur”, sipas meje, është ndër veprat më me vlera të dramaturgisë sonë në këto dy dekada, me elemente të realistës e surrealistes, të absurdës dhe ekzistencialës. Një veprë moderne me frymë brehtiane. Autori me gjuhën e artit i bën skanerin diktaturës enveriste në “organin” më të dhunshëm e kriminal, - sigurimi i shtetit, - arma vrasëse e lirisë së individit dhe shoqërisë. Mbështetur në një ngjarje reale, autori krijon një komedi dramatike....

.....faqe 21.....



Skulptori Gashi dhe Engjëlli i Kosovës i modeluar në baltë

### Engjëlli i Kosovës së lirë në Palais Liechtenstein në Vjenë

Klasi dhe vlerat e artit të skulptorit Destan Gashi në kulturën austriake të skulpturës. Historia e pazakontë e një restaurimi ku engjëjt e llampadarëve morën emrin e Kosovës....

NGA **PJETER LOGORECI**

.....faqe 22-23.....

### Dilemat e një Qendre kulturore kushtuar Fishtës

A ka ndonjë alternativë tjetër për ta nderuar Fishtën, dhe për të shmangur debatet dhe interesat që përplasen në rastin e shtëpisë së poetit?

NGA **DOM NIKË UKGJINI**

Figuira më e shquar e letërsisë shqiptare, Gjergj Fishta, edhe pse për 50 vjet të sistemit komunist u la në harresë, me kalimin e kohës vepra dhe personaliteti i tij sikur tërheqin më tepër vëmendjen e lexuesve dhe studiuesve vendas dhe të huaj.

Por tema e këtij shkrimi nuk është vlerësimi i veprimtarisë së tij letrare apo vendi i tij në letërsinë e sotme shqiptare, por thjesht shprehje e një mendimi ndryshe që ka të bëjë me restaurimin apo jo të shtëpisë së tij të banimit, apo duhet kërkuar solucion tjetër edhe më të përshtatshëm për ta nderuar këtë kolos të letrave shqipe...

.....faqe 24.....



DOKUMENTI I | PANJOHUR

Portret i Gjon Gazulit



Kapitulli i trete i dorëshkrimit te Gazulit

Faqja e pare (kapitulli i pare) i dorëshkrimit origjial te Gjon Gazulit nga Arkivi i Dubrovnikut

# Dorëshkrimi i rrallë mbi astronominë i Gjon Gazulit

Zbulohet në arkivin e dubrovnikut dokumenti prej 22 faqesh i humanistit shqiptar që flet për Astrolabin dhe yjësinë qiellore

DR. ETVLEVA LALA  
DR. MUSA AHMETI

vijon nga faqja 17

....Ky dorëshkrim është i mbuluar me vell misteri. Për të me saktësi dimë që është shkruar në Dubrovnik, me një kaligrafi të mrekullueshme kursiv gotik, të shekullit XV, karakteristikë për dorëshkrimet që u shkruan në Raguzë, por edhe më gjerë. Nuk na është e njohur se si ky dorëshkrim qëndroi për rreth pesë shekuj, më saktë për 485 vjet në familjen fisnike dubrovnikase Guçetiç, as si arriti në arkivin e njohur të kësaj familje dhe në cilat rrethana dhe kushte. Sipas procesverbaleve të ruajtura në Arkivin Historik të Dubrovnikut, sot dimë se në vitin 1950, pas vdekjes së pinjollit të fundit të kësaj familje, fisnikut Vit Guçetiçit, së bashku me shumë dorëshkrime, dokumente, inkunabula, libra të rrallë (rare) dhe eksponatë të tjera me vlera të paçmueshme, edhe ky dorëshkrim i Gjon Gazulit, kaloi në pronësi të Akivit Historik të Dubrovnikut, në Dubrovnik. (Sot i vendosur në Fondi: Bassegli-Gozze, Rukopisi, nr. 32, f. 271-281).

Edhe pse në një institucion "për ruajtjen e memories shkencore" siç është arkivi, ky dorëshkrim edhe për rreth 11 vite mbeti nën pluhurin e harresës, derisa ra në dorë të studiuesit të njohur kroat: Mirko Drazhen Grmek, në vitin 1961, i cili ka meritën kryesore për njohimin e botës shkencore, për ekzistimin e këtij dorëshkrimi si dhe për in-

## Boks 1


Në Arkivin e Dubrovnikut, dokumente, të dhëna dhe informacione të drejtëprdrejta apo të tërthorta për Gazulin ruhen në këto fonde: Acta Consilii Maioris; Acta Consilii Minoris; Acta Consilii Rogatorum; Debita Notariae; Distributiones Testamentorum; Diversa Notariae; Diversa Cancellariae; Liber Curiae Archiepiscopalis Ragusinae, an. 1464-1471; Letterae et commissiones Levantis; Miscellanea, saec. XV. Testi, Litterae, Varia, supplicationes; Serija XIV Chiese e Monasteri; Seria XXI, 2, Memoriae; Testamenta Notariae; etj.

formacionet themelore bazë mbi të. M. G. Grmek, fillimisht hodhi idenë se ky dorëshkrim mund të ishte i Gjon Gazulit (M. D. Grmek, L'raport, 1961), po pa u thelluar në analizë shkencore, pa ofruar fakte konkrete bindëse dhe të qëndrueshme për këtë pohim të tij. Në një studim të dytë me bashkautor Žarko Daić, që u botua në vitin 1976, ky autori thelloi më tej dijet për Gjon Gazulit dhe veprimtarinë e tij shkencore, por gjithnjë brenda kornizave të një studimi të kufizuar për revistë shkencore, jo monografie apo studim më gjithëpërfshirës. Edhe pse tashmë i njohur, ky dorëshkrim ende vuan nga misteri i harresës, mosintersimi për studimin e tij, nga të gjitha aspektet, paleografike, diplomatike, filigranes etj., por edhe nga mungesa e një editimi kritik dhe përkthimi të tërësishtëm.

Në një fletë të veçantë është një shënim me stilolaps me ngjyrë blu, nga viti 1950: "Debati për ndërtimin dhe përdorimin e astrolabit. Një shkrim i bukur gotik i shekullit XV. Duke gjykuar sipas shenjave të filigranes të cilat vërehen në letërën e dorëshkrimit, letra është prodhim italian nga viti 1460. Dorëshkrimi nuk ka titull dhe askund nuk është shënuar emri i autorit të tij. Në bazë të disa të dhënave të tjera, sipas gjitha gjasave, pothuajse është e sigurtë, që dorëshkrimin e ka përgatitur domenikani, astronomi dhe matematikani me emër, Gjon Gazuli. Dorëshkrimi ka arritur në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut në vitin 1950, pas vdekjes së pronarit të tij të fundit, Vit Gozze."

Dorëshkrimi në gjendjen e sotme ka 11 fletë përkatësisht 22 faqe të papagjinuara as në kohën e krijimit të tij, e as më vonë kur është bërë pjesë e Arkivit të Dubrovnikut. Nga studimi i originalit vërehet se 11 fletët





Kapitulli i dyte i dorëshkrimit të Gazulit

## Kush ishte Gjon Gazuli?

Gjon Gazuli është njëri ndër humanistët më të shquar të mesjetës shqiptare. Ka lindur në fillim të shekullit XV në Dubrovnik dhe vdiq më 19 shkurt të vitit 1465 po në Dubrovnik. Familja e tij ishte me origjinë nga Gjadri i Zadrimës. Nga burimet dokumentare të ruajtura në Arkivin Historik të Dubrovnikut, veçanërisht nga fondi Testamenta Notariae, kemi mundur të ndjekim qëndrimin e familjes Gazuli që nga fillim shek. XIV në Raguzë e deri në fund-shekullin XVI. Gjon Gazuli studioi në Raguzë, për të vazhduar pastaj në Padovë. Në vitin 1428 mbaroi studimet për teologji dhe filozofi në Padova, studime këto që i kishte filluar në vitin 1422, ndërsa më 31 janar të vitit 1430 doktoroi në filozofi e teologji. Kur kthehet në Dubrovnik emërohet prior i Kuvendit Domenikan në Raguzë, dhe menjëherë angazhohet në misionet të shumta diplomatike nga raguzanët. Nga viti 1439 emërohet profesor në katedrën e matematikës pranë Universitetit të Padovës. Po ashtu kishte njohje personale me Gjergj Kastriotin Skenderbeun, për llogari të të cilët më shumë se një herë bëri punën e ambasadorit. Emri dhe fama që kishte e bënë të jetë i ftuar në rrethet e larta shkencore-humaniste të kohës. U ftua edhe nga mbreti hungarez, Korvini, po për arsye jo shumë të qarta nuk shkoi. Edhe dy vëllëzërit e tij Pali e Andrea i shërbyen Gj. K. Skenderbeut. Pali ishte edhe rektor i Gjinnazit publik të Raguzës.

që ne kemi në dorë kanë qenë pjesë e një dorëshkrimi më të vëllimshëm. Kjo gjë vërtetohet nga "kurrizi" i dorëshkrimit, ku kanë mbetur ende disa "pjesë" të lidhjes së vjetër, pastaj qepja me dorë me një fije peri të veçantë kohës, etj (shih ilustrimin për këtë).

Dorëshkrimi është i shkruar me një kaligrafi të bukur të shkruar me miuskul gotik të pjesës së dytë të shekullit XV dhe është i lehtë për t'u lexuar për paleografët. Bojërat e përdorura për dorëshkrim janë: ngjyra kaqe (që dominon në 9 fletë/18 faqe/ dhe pjesërisht në dy faqet e tjera) dhe ngjyra e kuqe në dy faqe, përkatësisht në faqet 8 e 9 të dorëshkrimit. (Për të pasur më të lehtë studiuesit, paleografët, historianët, astronomët dhe të interesuarit e tjerë, ne po i bëjmë citimet në vijueshmëri të f. 1 deri me 21, e jo sipas fletëve, që në ndonjë rast, për ata që nuk e njohin lëndën, mund të sjellë edhe ngatërrim).

Dorëshkrimi është shkruar në letër cilësore gjysëm karton, prodhim italian i vitit 1460, e prodhuar në qytetet italiane të Ferrarës, Firencës dhe Venedikut (Për këtë shih më shumë katalogune filigranes të C. M. Briquest, 1923, v. II, nr. 7465 dhe 7468). Kjo gjë vërtetohet nga shenjat e ujit (filigranes) të cilat vërehen në f. 4 dhe f. 20, ilustrimin e të cilave po e botojmë këtu. Dimesionet e letres së dorëshkrimit janë: 22.1 x 33.4 cm. Teskti është i tiri në gjuhën latine dhe është shkruar sipas një shablloni të përgatitur që më parë brenda dimensioneve: 17.6 x 28.7 cm, përkatësisht marginat boshe horizontalisht majtas janë 2 cm, ndërsa dajthtas 2.5 cm, kurse vertikalisht, lart margina

## Boks 2

Në burimet arkivore, mbiemrin e Gjon Gazulit e gjejmë në forma të ndryshme, varësisht nga gjuha në të cilën shkruhet psh.: Gasolo, Gasolus, Gassolus, Gazuli, Gaxulus, Gazola, Gazulus, Gazul, Gazulic, Gazulus, Gazzulus, ndërsa emrin në formën: Johannes, Giovanni, Ivan dhe në shqip Gjin (sic) e Gjon. Autorët shqiptarë që kanë shkruar për Gazulin deri me sot janë të pakta, mund të përmendim vetëm: J. Drançollin e M. Zeqon.

boshe është 1,5 cm, ndërsa poshtë është 3.2 cm, i shtrirë në 46 rreshta brenda një faqeje.


Dorëshkrimi nuk është i dekoruar me iniciale të veçanta, por vendi i tyre është bosh, sepse ato duhej t'i punonte një specialist i posaçëm, iluminator i inicialeve, me ngjyra dhe elemente të ndryshme dekorative nga bota bimore, shtazore apo figura të ndryshme ilustruese që kishin lidhje me dorëshkrimin.

Dorëshkrimi përbëhet nga tre njësi, ku dy të parat janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, ndërsa njësia e tretë, është e veçantë dhe nuk ka të bëjë fare me dy të parat. Asnjëra nga tre njësitë nuk ka titull apo nëntitull dallues (sikurse as dorëshkrimi), por dallimin e tyre e kemi bërë pas një studimi të përgjithshëm të tekstit të dorëshkrimit si dhe propozimit të ndarjes që fillimisht ka bërë edhe M. D. Grmek (1976). Tërësia e parë fillon në f. 1 e vazhdon deri në f. 5. Ajo nis me fjalët: "Antequam astralabij utilitates aedamam necessaria est nobis terminorum sive nominum instrumenti expositio" dhe mund të kishte titullin: "Përdorimi i astrolabit..." që bën fjalë kryesisht për astrolabin dhe përdorim e tij në kohën kur u shkrua studimi nga Gjon Gazuli. Tërësia e dytë është në f. 5 (12 rreshtat e fundit të f. 5) dhe vazhdon deri në f. 10, duke filluar me fjalët: "Astralabium componere respice tabulam aptam in cuius medie quere centrum quod vocetur(e) super quo describe circulum secundum exigentiam tabule maiorem quam poteris..." dhe mund të kishte titullin: "Ndërtimi i astrolabit" dhe bën fjalë për mënyrën e ndërtimit të astrolabit dhe funksionimin e tij. Tërësia e tretë e dorëshkrimit fillon në f. 11 për të vazhduar deri në f. 21.

vijon në faqen 20



DOKUMENTI I | PANJOHUR



vijon nga faqja 19

....Kjo tërësi mund të kishte titullin: "Studim mbi gjurmët dhe lëvizjet e planetëve" dhe fillon me tekstin: "Circulus dicitur ecentricus vel egressus cuspidis vel egradientur centri qui non habet centrum cum mundo." Si duket kjo pjesë është shkëputur nga një studim shumë më i gjërë dhe i hollësishtëm i Gjon Gazulit gjurmët e të cilët ne i gjejmë sot në dy biblioteka: në Krakov dhe Vjenë.

Një informacion me shumë vlerë për krijimtarinë e Gjon Gazulit gjëjmë në kodikun e bibliotekës së Jagiellonskij në Krakov të Polonisë, me titull: "Theorica novae planetarum", me autor Georgius de Peurbach (1423-1461), që sot ruhet në signaturë: Rps 599, f. 1r-43r, ku ai sjell vizatime nga vepra në dorëshkrim e Gazulit për problemet astrologjike të "shtëpive qiellore" dhe sipas të gjitha gjasave edhe tërëisa e tretë e dorëshkrimit të Gjon Gazulit që ruhet në Arkivin e Dubrovnikut është e përfshirë e tëra në këtë dorëshkrim të Peurbach-it. Ky dorëshkrim është nga shek. XV, përkatësisht nga viti 1454, sipas një shënimi që është shënuar në faqen e fundit të vetë kodikut. Kjo datë ka shumë rëndësi, sepse nëse Georgius de Peurbach-i ka shfrytëzuar dorëshkrimin e Gazulit në vitin 1454, mund të nxjerrim një përfundim se ky dorëshkrim është shkruar para këtij viti dhe se dorëshkrimi që ne kemi shfrytëzuar në Arkivin e Dubrovnikut e që është nga viti 1460, është kopje e dorëshkrimit të vitit 1454 ose bocet i përgatitur për botim.


Një kopje tjetër e dorëshkrimit të Peurbach-it ruhet në Vjenë, në Österreichische Nationalbibliothek, në signaturën: Cod. 5203. Ky kodik është i shkruar në letër gjysëm kartoni të fortë, ka dimensione 21x14.6cm/dimensionet e tekstit: 13.4 x 7cm/dhe është autograf origjinal. Ai ka gjithsej 48 fletë (1r-48v) dhe në f. 43r-v është një shenim i shkurtër për Gjon Gazulin, në 32 rreshta. Ky kodik sipas shënimit që ka në faqen e fundit, 48v, është shkruar më 30 gusht 1454.

Gjithnji duke mbetur rreth vitit 1460, kemi një dokument tjetër shumë të çmuar për vepërimitarinë shkencore të Gazulit, përkatësisht letrën e Jan Česmičkít (Janus Pannonius, njëri prej poetëve më njohur të shekullit të XV), që ia dërgoi Gjon Gazulit në vitin 1460 dhe në të cilën ai e falënderon Gazulin për dorëshkrimin që i kishte dërguar dhe që Česmičkít e kishte marrë. Për shkak të rëndësisë historike që ka, po edhe për të përfurcuar pohime që bëjmë më sipër, ne e sjellim atë të përkthyer në shqip: "Ju, jo vetëm që kemi përbushur shpresën që ne kemi pasur në Ju, por keni avancuar (shkruar) shumë më larg. Librin që na keni dërguar, na ka pëlqyer jashtëzakonisht shumë. Ai është plot me njohuri dhe oratori, dhe leximi i tij ishte kënaqës, ashtu siç ishte i dobishëm studimi i tij. E pranojmë se kemi gjetur

Mbi humanistin Gjon Gazuli

Numri i humanistëve shqiptarë që bënë emër të nderuar në Europën mesjtare nuk është i vogël. Ndër më të dalluarit është Gjon Gazuli. U shqua si prift i devotshëm në Urdhërin e Domenikanëve, duke pasur pozita drejtuese, si profesor i matematikës në Universitetin e Padovës, si diplomat i Raguzës, i mbretit hungarez Sigismundit dhe heroit shqiptar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Kishte raporte e bashkëpunoi me emrat më të nderuar të humanizmit e renesancës. Shkroi shumë vepra, po me sa dihet deri me sot asnjëra nga ato nuk u botua. Dorëshkrimet e veprave të Gjon Gazulit dalëngadalë, pas shumë hulumtimesh, kërkimesh shkencore, ballafaqimesh e analizash po dalin në dritë. Si kontribut për këtë humanist të nderuar shqiptar është edhe botimi i dorëshkrimit të veprës së tij autograf nga Arkivi i Dubrovnikut.

Ilustrim nga dorëshkrimi i Gazulit



zgjidhje për disa gjëra e pohime të pasqaruara sa duhet deri me tani të astrologëve të lashtë, të cilat para shumë kohësh kemi dëshiruar t'i kuptojmë drejt. Për këtë shkak seriozisht ju nxisim që të vazhdoni të shkruani dhe të kompletoni përfundimisht punët e filluara, të cilat do të jenë shumë të domosdoshme për dijetarët, po ashtu edhe për reputacionin tuaj, kështu që do përbushni dëshirën tonë, prapa së cilës qëndrojmë me shumë forcë. Ju lutemi shumë, përveç kësaj, që të na vini në dispozicion sferat e armiluara të Ptolemeut dhe pajisjet e tjera që ju përmendeni në veprën tuaj. Ju ato i përgatitni atje me shpenzim tona, sepse këtu në Mbretërinë Hungareze nuk kemi asnjë zejtari i cili do ishte i zoti në këto punë. Të gjitha shpenzimet do t'ju kompensojmë në mënyrë efektive në qytetin tuaj ose në një vend tjetër të përshtatshëm për ju." (Për këtë dokument shih edhe: F. Banfi, 1939, M. D. Grmek, Z. Dadić, 1976).

Dëshmitë për famën shkencore dhe për krijimtarinë e Gjon Gazulit e veprat e tij janë të shpërndara gjithandej. Në Biblioteca Apostolica Vaticana, në Vatikan, në fondin e dorëshkrimeve ruhet një kodik, i cili ka të dhëna me mjaft interes për astronomin shqiptar. Kodiku ruhet në këtë signaturë: Mss. Codicus Palatinus 1375. Informacioni për Gjon Gazulin është në f. 268v. E sjellim në vijim sipas originalit në latinisht: "Hec figuratio ostendit equationem domorum quam possuit Campanus quem etiam seguutus est magister Johannes Gazulus Rausiensis in tractatus suo de directionibus et fit hec equatio tali modo inter circulos qui uadunt per uerticem capitis dicuntur azimut est unus medius qui extenditur per ortum et oqasum equinoctialis hunc circulum subdividunt in 12 partes euales et per illas diuisiones ymaginatur extendi sex magnos circulos in ambabus intersectionibus meridiani cum horizonte concurrentes: inter quos circulos meridianus et orizon sunt principales. Hij sex circuli semper sunt fixi et equalia spatia celi unaquaque domus continet. Sex etiam domus tote et integre sunt super terram et sex integre sub terra sunt quod non fit secundum primam equationem erroneam ubi domus 12 sunt diuise ab oriente sicque omens 12 secundum aliquam partem sunt super terram et econtrarium secundum alteram sunt sub terra quod est contra omnium uetustissimorum astrologorum opinionem." Pra edhe këtu, sikurse në dorëshkrimin e Kodikut të Krakovit, bëhet fjalë për studimet e Gazulit, metodat dhe punën e tij në fushën e astronomisë. Dorëshkrimi i BAV-it, përmban informacione të vlefshme për Gazulin, pra nuk është autograf i tij. Scribes i kodikut të BAV është humanisti i njohur i fund shek. XV, Johannes de Hasfurth, i cili ka kopjuar nga dorëshkrimet e Gjon Gazulit "tabelat astronomike" dhe "mundësitë e ndarjes së qiejve" rreth vitit 1488, kur ishte në Krakov. Përveç BAV-it, edhe Bibliotheqe Nationale de Paris zotëron një kodik tjetër me signaturë: Mss. Lat. 10265, nga shek. XV, ku kemi të përshkruara punimet e Gjon Gazulit të dhënat numerike për "shtëpitë qiellore" dhe axtrolabin. (Me këtë rast falënderojmë publikisht prof. Aleksandër Meksin, që na ka sjellë riprodhimet e këtij kodiku, me të dhënat për G. Gazulin nga Parisi).

Faqja e parë e dorëshkrimit nga biblioteka Jagiellonskij e Krakovit kur ruhet shenimi për Gjon Gazulin, shek. XV



ART | SKENIK

MEXHIT PRENCI

**A**të që zakonisht thuhet në fund pas një analize kritike, po e artikuloj në fillim: komedia dramatike e Armado Borës "Ata hyjnë pa trokitur", sipas meje, është ndër veprat më me vlera të dramaturgjisë sonë në këto dy dekada, me elemente të realistes e surrealistes, të absurdes dhe ekzistenciales. Një veper moderne me frymë brehtiane. Autori me gjuhën e artit i bën skanerin diktaturës enveriste në "organin" më të dhunshëm e kriminal, - sigurimi i shtetit, - arma vrasëse e lirisë së individit dhe shoqërisë. Mbështetur në një ngjarje reale, autori krijon një komedi dramatike ku çifti Burrë-Grua presin nga çasti në çast t'i internojnë apo burgosin. Mënyra si e ka shestuar, formësuar dhe trajtuar dramën e tyre duke aplikuar komiken e dramatikën, groteskun dhe realisten, ironinë dhe satirën është e mrekullueshme. Autori jep me art të klasit të parë dhunën, trysnitë psikologjike dhe torturat shpirtërore të dy personazheve dhe në të njëjtën kohë fshikullon, stigmatizon, satirizon dhe ironizon "Ata hyjnë pa trokitur".

Është një mënyrë origjinale e shestitimit dhe stukturimit të kësaj vepre e cila realizon artistikisht me sukses modelin më të keq të dhunës psikologjike të kohës pa liri të socializmit enveriste, për t'i kumtuar të sotmes se një neodiktaturë po shfaqet argesive duke dhunuar liritë e të drejtat individuale dhe kolektive të njeriut. Në këtë vështrim komedia dramatike "Ata hyjnë pa trokitur" është veper provokative e guximshme, me mesazhe të fuqishme.

Togfjalëshi "Ata hyjnë pa trokitur" është gjetje artistike e jashtëzakonshme ku fanatistikja, e mrekullueshmja dhe çuditore shkrihen së toku. Autori "ata" nuk i personalizojnë, nuk i paraqet fizikisht në skenë, por jep imazhin e tyre si simbol të sistemit të tmerrshëm të censurës së egër, që shfaqet në forma të ndryshme në vetëdijen e personazheve: si fobi, ankth, fantazmagori, trysni psikologjike, tronditje shpirtërore; herë në dritare, herë të porta, herë në oborr e gjithëherë rrotull shtëpisë e kudo.

Përtej tekstit shoh jo vetëm personazhet Burrë e Grua në këtë ferr torturues, por një pjesë të madhe e shoqërisë, duke patur parasysh se vepra është reflektim i realitetit të shtetit totalitarist komunist. Trysnia psikologjike është demonjake, shkatërruese. Autorit është ngacmuar të shkruaj këtë dramë-komike nga rrefimi dramatik i pedagogut të tij Pirro Manit, I cili priste me bashkëshorten Pavlina, në një gjendje të rëndë psikologjike pas shfaqjes të disa premierave, trokitjet e zeza në protën e tij, ku valigjet ishin bërë gati. Bora me një frymë e ka shkruar veprën duke i dhënë dimensionin artistiko-skenik, por nuk e ka konsideruar të mbaruar siç shprehet ai. Në intervale kohore e ka përpunuar. Madje e ka vënë edhe në skenë një vit pasi e ka shkruar. Po përsëri nuk ka mbetur i kënaqur. Pas pothuajse dhjetë vitesh arrin në këtë variant me vlera të larta artistike, estetike dhe mesazhore. Ka shfrytëzuar fushën e formave të jetës reale dhe atë artistike, larmia e të cilave është e pafundme, siç thoshte Hegeli.

Fokusimi të drama psikologjike e personazheve, të bota e brendshme e tyre duke mos përfillur rregullat e komedisë klasike dhe realiste, linjat e zhvillimit kronologjik të ngjarjeve dhe personazheve, ka mundësuar krijimin e strukturave dramaturgjike moderne funksionale, me kundërvenie brenda e jashtë vetjes së personazheve, të cilët vihen në situata komike dhe dramatike të shumta e të larmishme. gjithnjë nën trysninë e fobisë nga gjuajtja e shtriganëve të luftës klasave.

Integrimi i komikes me dramatikën është çelsi i suksesit të kësaj vepre. Tysnia psikologjike ndaj personazheve është kaq e madhe sa ata kalojnë në depresion, tjetërsim, dyzim, lojë, "çmenduri". Në të njëjtën kohë mënyra si stigmatizohet dhe vihet në lojë, me mjete artistike groteske dhe ironike, është sa



Nga shfaqja "Ata hyjnë pa trokitur"

# "Ata hyjnë pa trokitur", persiatje për një komedi dramatike të Armando Borës

Një shfaqje që përcjell mesazhin se si duhet të refuzohet çdo model diktature si ajo që lamë pas, ashtu edhe neodiktatura e sotme, e cila në forma të ndryshme e të kamufluara, autoritetin e Njëshit po e ngre në kult...

origjinale aq prurje e re dramatiko-komike. Togfjalëshi "Ata hyjnë pa trokitur" siç e cika më sipër, është një gjetje magjike, boshtr rreth të cilit lëvizin dy personazhet pushtuar nga frika dhe tmerr duke kaluar nga situata në situatë, nga një gjendje psikologjike në tjetrën, me veprime psikofizike dinamike dhe me ritëm të lartë. Në vëzhgimin tim komedia dramatike e Borës solli risi në shestitim, këndvështrim, strukturim të veprës, në aplikimin e groteskut, satirës dhe ironisë, të situatave komiko-dramatike, të thyerjes të rregullave e kanoneve. Me liri të plotë autori, ka ngritur në art realitetin: me ngjarjet, situatat dhe veprimet psikofizike të personazheve në variacione të larmishme e të shumta. Inskenimi i një vepre të tillë moderne, paraqet vështirësi serioze për çdo regjisor edhe për profesionistë, e nëse u realizua me nivel të lartë nga regjisor Bora, kjo u arrit edhe se autori i veprës është dhe regjisor i saj, i cili që gjatë procesit të krijimit të kësaj komedie dramatike, ka patur parasysh kërkesat e skenës në tërësi elementet përbërës, që tek teksti,

personazhet, dialogu, monologu, ngjarjet e situatat, atmosfera, mjedisi dhe konflikti brenda e jashtë personazhit i cili herë përjeton dramën, herë distancohet nga figura dhe vë në lojë, nëpër situatë komiko-dramatike, ata që hyjnë kudo pa trokitur.

Faktor tjetër i suksesit të spektaklit është edhe përzgjedhja e aktorit Alfred Trebicka dhe aktorese Rozi Kostani të cilët janë jo vetëm aktorë të kasit të parë, por edhe regjisorë. Kjo treshe ka një specifikë të veçantë, secili është edhe aktor edhe regjisor. Gjatë procesit të inskenimit kanë dialoguar, debatuar, janë "grindur", sigurisht pa shkelur etikën profesionale, (siç bëjnë parlamentarët) gjersa kanë gjetur dakorsinë e shestitimit regjisorial me Borën, por edhe dakortësinë e veprimeve psikofizike të personazheve, sipas karakterit të tyre dhe mënyrën si do t'i realizonin figurat respektive burr -grua. Ndalem të aktrimit i Trebickës-Burri dhe Kotanit-Gruaja, si e përjetojnë fobinë e tmerrshme ku me ankth presin nga çasti në çast se mund t'i arresojnë, t'i burgosin. Me

sytë e mendjes, drithmat e zemës dhe gjithë genien psikofizike të tyre, i ndejnë dhe shohin "Ata hyjnë pa trokitur" si hije të zeza kudo: në mendjen, zemrën dhe shpirtin e tyre, prapa dera, prapa dritaresh, jashtë në rrugë, në oborr, brenda vetes e jashtë vetes. Halucinationet shfaqen në mënyra e forma të ndryshme.

Ky realiteti artistik skenik është vlerë e dramës, por sidomos e lojës brilante të Trebickës dhe Kostanit. Trebicka që nga artikulli i fjalës me tërë koloritin gjuhësor, në veprimet psikofizike dhe plastike të figurës artistike, (sikur ka hyrë në ujë), shpreh me art të epërm, ferrin nga trysnitë psikologjike që e kanë tjetërsuar. Në mënyrën e vet aktron edhe Kostani partnere e denjë me Trebickën. Në aktrimin e saj shquaj një aktore të realizuar. Mjeshtëria artistike e së cilës në formësimin e figurës është e nivelit të lartë, falë temperamentit, të të vetëdijerit të lartë, të plastikës dhe aftësisë përceptuese e përjetuese të cilat i aplikojnë me sukses në artikullimin e fjalës dhe të veprimeve psikofizike, edhe pse teksti herë-herë nuk jep mundësi të konsiderueshme as Kotanit as Trebickës në procesin psikologjik të kalimit nga një situata në tjetrën, nga dramatikja në komike.

Aktrimi i tyre Trebicka-Burri, Kotani-Gruaja është mjeshtëror në rrafshin e realistes, surrealistes dhe të absurdit. Sjell risi në lojën e aktorit. Veprimet psikofizike të tyre sipas situatave dramatike e komike janë të natyrshme, me sensin e masës. Ngarkesat emocionale dhe kalimi nga një gjendje psikologjike ekzistencialë në atë komike, nga ajo lirike e dramatike dhe absurde është realizuar me nivel artistik. Trebicka e artikullon fjalën herë me zë të dridhur gjithë frikë, herë me tone të ulta, herë të larta, herë me pëshërëtimë. Nuk bërtet, nuk ulurinë, nuk vrapon si i marrë në skenë, siç ndodh rëndom në spektakle të ndryshme. Po kështu edhe Kotani. E ndonëse në ndonjë rast e ngrenë zërin e bartasin, kjo është artistike dhe estetike, nuk t'i çjerret veshët, nuk të mërzit, si në disa spektakle që keqinterpretohen modernia dhe abuzohet me lirinë krijuese. Kotani dhe Trebicka herë tjetërsohen në figurë, herë distancohen prej saj duke vënë në lojë shtriganët e padukshëm të luftës së klasave dhe gjithë sistemin censurues të pamëshirshëm të diktaturës, ku mjeshtëria interpretuese është vlerë e epërme artistike dhe estetike. Spektakli "Ata hyjnë pa trokitur" komunikojn me publikun e sallës nëpërmjet mesazheve që marrin nga teksti, gjuha regjisoriale dhe aktrimit i mrekullueshëm. E konsideroj vlerë edhe mënyrën se si është shestuar dhe formësuar spektakli duke mos i mësuar këtyrë apo atij mesazhi nga regjia, çka secili prej publikut sipas përceptimit dhe arsyetimit të tij, merr mesazhin që formulon vetë. Sipas meje një nga mesazhet substancial të këtyrë spektakli është: të refuzohet çdo model diktature si ajo që lamë pas, ashtu edhe e neodiktatura e sotme, e cila në forma të ndryshme e të kamufluara, autoritetin e Njëshit po e ngre në kult....

Ky mesazh, më shumë se provokues, është thirrje lirie për individin dhe shoqërinë që të mos lejojnë që rrota e historisë të kthehet prapa.

## ART | PATRIOTIZËM



Pallati Liechtenstein në Bankgasse të Vjenës

NGA PJETER LOGORECI

# Engjëlli i Kosovës së lirë në Palais Liechtenstein në Vjenë

Klasi dhe vlerat e artit të skulptorit Destan Gashi në kulturën austriake të skulpturës. Historia e pazakontë e një restaurimi ku engjëjt e llampadarëve morën emrin e Kosovës....

**E**shtë hera e dytë që paraqitem përpara lexuesit shqiptar me personazhin Destan Gashi, artistin, gdhendësin e gurit i cili jeton dhe punon në Vjenë të Austrisë. Shkrimi i parë ishte një informacion i mirëfillt për jetën dhe fillimet e karrierës së tij, ndërsa në këtë shkrim, dëshiroj të paraqes lexuesit kulminet e karrierës së tij të arritur deri më sot, të cilat do të kishte zili çdo artist përëndimor e që bëjnë krenar çdo shqiptar kudo që jeton.

\*\*\*  
Një ndër perlat e bukurive e madhështive të Vjenës është edhe pallati Liechtenstein ose në gjuhën e vendit PALAIS LIECHTENSTEIN, i cili për nga pozicioni i ndertesës, gjendet në qendër të qytetit, në bashkinë e parë, në një rresht me kryeministrinë, pranë presidencës, ministrisë së jashtme asaj të arsimit apo asaj të brendshme dhe pranë rezidencës perandorake. Pallati në Bankgasse, është pronë e familjes aristokrate të princave të Liechtenstein-it e ndërtaur sipas stilit Baroque dhe ka filluar të ndërtohet rreth viteve 1691 me kërkesën e Kontit Kaunitz, i cili për arsye ekonomike ja kaloi objektin mjeshtrit të ndertimit Enrico Zucallit, skicat e të cilit u zbatuan nga drejtuesi i punimeve Dominic Martinelli. Pallatin e bleu të papërfunduar Princi Johann Adam I von Liechtenstein në vitin 1694, i cili vendosi ta kishte si rezidencë qëndrore. Punimet përfunduan në vitin 1705 nga ndërtesuesit Gabrieli dhe Martinelli. Ky i fundit projekttoi një portal madhështor, i cili ishte i pari objekt i stilit Baroque në Vjenë. Pallati ka në brendësi shumë apartamente banimi, dhoma të mëdha ngrëniat, zyra, ambiente pushimit, dhoma për të banuar personeli i shërbimit apo sallone takimesh në mes aristokratëve. Një pjesë e madhe e pallatit është llogaritur për të ekspozuar koleksionet e kryevepra artistike të ndryshme që zotëronte familja, të cilat u hapën për miqtë dhe vizitorët e familjes që në fillim të 1705-ës.

Rreth vitit 1807, familja që zotëronte edhe një galeri arti në Vjenë, shpërnguli atje koleksionet e artit duke e lënë pallatin e Bankgasse-s të pabanuar. Në vitin 1836 me ardhjen në qeveri të një pjestari të familjes Princit Alois II von Liechtenstein, pallati ju bë një rinovim dhe një arredim i brendshëm nga arkitekti anglez Peter Hubert Desvignes (1836 – 1847), i cili ndryshoi shumë pjesë të stilit Baroque nga dekorimet e brendshme. Shumë punime të brendshme si tavane, muret, parketi i dhomave janë punime dore nga mjeshtra shumë të njohur si Carl Leistler apo Michael Thonet. Pallati u bë shumë i famshëm për elegancën e zbukurimeve të bëra me Kautschuk (atëkohe shumë i shtrenjtë), Mëndafsh, Fildish, pasqyra kristali, në të gjithë komponentet e tij. Mbas 10 viteve punimesh restaurimi, pallati u hap me 16 shkurt 1848 duke u inaguruar me një ballo shumë të famshme për shoqërinë vjeneze. Për kuriozitet për lexuesin, vlera financiare e këtyre punimeve ishte afro 120 milion euro (në atë kohë 4 milion gulden). Që nga kjo rihapje, pallati u bë një ndër objektet më të bukura dhe të preferuara nga shoqëria e lartë në kryeqytet.

Një restaurim rifreskimi e pastrimi të objekteve (më i madhi që është njohur në Vjenë) u bë së fundi nga viti 2008 deri 2013-tën. Pallati kishte nevojë për një aksion të tillë pasi gjatë luftës së dytë botërore ai pat dëmtime të mëdha (një avion lufte ishte rrezuar në pjesët e shkallëve nga ana Löwelstrasse) dhe atë kohë riparimet ishin bërë sipërfaqësore. Por ajo që ja vlen të përmendet ishte restaurimi i elementëve artistik, si tapiceritë, figurat e ndryshme e skulpturat e vendosura në tavane, kolona apo cepa muresh, të dyshemesë, tavaneve dhe të llampadarëve, që u riparuan me materiale autentike dhe nga mjeshtrat më në zë të Austrisë.

\*\*\*  
Shqiptari Destan Gashi dhe skulptura e tij në Bouquetsaal të Palais Liechtenstein Ashtu si objektet e tjera, edhe llampadarët e shumtë, kryevepra arti e elegance, të varur në të gjithë ambientet e Pallatit Liechtenstein, ishin shumë të dëmtuar nga Lufta e Dytë Botërore. Disa prej tyre mund të riparoheshin, por disa të tjerë duheshin punuar si të rinj, nga fillimi. Për këtë, punën me llampadarët e mori përsipër firma vjeneze Lobmeyr, e cila njihet në të gjithë Austrinë (e më gjërë) për traditën shumëvjeçare në punimin e llampadarëve, në të gjitha format e madhësitë. Duke shfrytëzuar fotot apo skicimet e vjetra të objekteve, firma arriti të përshtasë po ato llampadarë që vareshin dikur në tavane e pallatit të famshëm. Pjesë e shumë detajeve përbërëse të ndriçuesve ishin edhe dy figura engjujsh në madhësinë e një fëmije të porsalindur, të cilët për fat egzistonin të fotografuar. Arkitekti kurator i familjes së Princit të Liechtenstein-it, pasi u njoh me punën e skulptorit shqiptar



# MES KRYEMJESHTRAVE

Në pallatin ku u vendosn veprat e skulptorit kosovar ruhet një koleksionin privat i familjes princore, ku veçohen vepra të mjeshtrave: Peter Paul Rubens, Rembrandt, Anthonis van Dyck, Lucas Cranach (i vjetri), Frans Hals, Raffael, Friedrich von Amerling, Ferdinand Georg Waldmüller si dhe objekte Badmindton Cabine, një mobilje nga më të çmueshmet në botë e krijuar në Firenze në punishten Pietra Dura të familjes Medici



Engjëlli ditën që u vendos në ndricues



Salla e mrekullueshme Bouquet ku u vendosën dy ndricuesit me engjujt e Destan Gashit

Destan Gashi, ngarkoi atë që të krijojë për lllampadarët e pallatit princor figurën e engjëllit. Përsonalisht pata fatin që të asistojta në shumë faza të punës në atelie, ku engjëlli rritej çdo ditë. Meqënëse bisedat në mes meje dhe skulptorit Gashi silleshin shpesh mbi Kosovën dhe historitë e vështira të popullit tonë, filluam ta thirrnim objektin-engjëll gjatë bisedave "Engjëlli i Kosovës". Pra e "pagëzuan" veprën që më pas do të ishte pjesa më e dukëshme në ndricues si "Engjëlli i Kosovës së lirë".

Skulptori Gashi, i cili ishte i ndergjegjshëm për rëndësinë e kësaj vepre, për "kontratën e engjëllit" që lidhej me vlerësimin e artit dhe personalitetit të tij, i kushtoj shumë kujdes dhe i fali veprës të gjitha energjitë e tij shpirtërore dhe emocionale, për ta realizuar në parametrat artistike e kohor të kërkuar nga shtëpia e artit në Vjenë. Në një takim pune në atelienë e Destan Gashit në Himberg, ku një grup nga ekspertët e Palais Liechtenstein me në krye arkitektin kurator, kishin ardhur për të kundruar "objektin e porositur", kënaqësia dhe mahnitja e ekspertëve nga bukuria e punimit ishte e papërshkrueshme.

Autori Gashi, me fantazinë e talentin e tij, kishte krijuar pothuajse nga hiçi një punim artistik që i befasoni të gjithë. Ai kishte arritur që nga një foto pothuajse e pa lexueshme, të kompozojë "Engjëllin e Kosovës së lirë", që i përmbushte të gjitha kërkesat dhe që e kenaqi pa masë arkitektin porositor. Një moment tjetër i veçantë dhe emocional, për të gjithë ne që ishim të pranishëm, ishte dita e vendosjes së engjëllit, të derdhur në bronz, në ndricuesit e sapo montuar. Grupi i madh i specialistëve si nga firma Lobmeyr ashtu edhe nga Pallati Princor Liechtenstein, i silleshin rotull shumë të kënaqur ndricuesit që varej në oborrin e firmës. U befasona pozitivisht dhe u ndjeva krenar si shqiptar por edhe si miku i artistit, kur pas lavdeve dhe përgëzimeve për bukurinë engjëllit e të ndricuesit, dëgjova skulptorin Gashi që po i shprehte një dëshirë arkitektit kurator (punëdhënësit): ....Ju lutem, a mund ta ma plotësoni një dëshirë?.....

- Më thuaj - ju përgjegj arkitekti austriak i befason e kurioz në pritje të kërkesës...  
-A mund ta vendosni të gdhendur fjalën KOSOVE pranë nënshkrimit tim në

miniaturë që do vendoset në këmbën e engjëllit? Arkitekti premtoi që do ta shikojë teknikisht në se do mund të plotësohet kërkesa e skulptorit patriot, i cili është një dует i pandarë me flamurin kombëtar e atdheun.

Me datën 13 nandor 2014, dy lllampadarët e veshur në ar dhe të ndërtuar sipas origjinalit, zunë vend në sallën me bukuritë rrallë, Bouquet të pallatit Liechtenstein në Bankgasse. Në mes të luksit të sallonit, ku varen vepra të mjeshtrave të mëdhej botëror apo ka objekte zbulurimi nga më të njohurat në botë, varen edhe dy "ENGJUJT E KOSOVES SE LIRE" dalë nga dora e skulptorit shqiptar Destan Gashi.

Më pas, gjatë vizitës sime në pallat, pasi i pashë dhe i fotografova engjujt (dy lllampadarët) shumë të njohur për mue, kërkova të informohem për veprat e artit që përmban koleksioni i rëndësishëm i pallatit të cilat bashkëshoqërojnë veprën e shqiptarit Gashi ndër ambientet më mondane dhe artistike të Vjenës. Më informuan që në koleksionin privat (që gjndesh në pallat), familja princore zotëronë vepra të mjeshtrave Peter Paul Rubens, Rembrandt, Anthonis van Dyck, Lucas Cranach (i vjetri), Frans Hals, Raffael, Friedrich von Amerling, Ferdinand Georg Waldmüller si dhe objekte Badmindton Cabine, një mobilje nga më të çmueshmet në botë e krijuar në Firenze në punishten Pietra Dura të familjes Medici.



Engjëlli i përfunduar në baltë

Edhe pse kisha dëgjuar disa herë fjalët dhe vlerësimet me superlativa, për "krijimin - Engjëll", drejtuar skulptorit Destan Gashi nga ekspertet e artit të pallatit, sjellja dhe pritja që përjetova ditën e vizitës time aty, më bëri të jem krenar për mikun tim shqiptar, që ishte aq i vlerësuar dhe i mirëpritur ndër rangjet më të larta të koleksionistëve e të eksperteve të artit të Austrisë, pa harruar që dyert e këtij suksesti të papërshkruar ja hapi talenti, dashuria e përkushtimi për artin, bukuria e veprave të dala nga duart e tija....

Shënim: Objektet janë fotografue nga Pjeter Logoreci Wien, 20.12.2014

SHTËPIA | KUVENDI

DOM NIKË UKJINI

**F**igura më e shquar e letërsisë shqiptare, Gjergj Fishta, edhe pse për 50 vjet të sistemit komunist u la në harresë, me kalimin e kohës vepra dhe personaliteti i tij sikur tërheqin më tepër vëmendjen e lexuesve dhe studiuesve vendas dhe të huaj.

Por tema e këtij shkrimi nuk është vlerësimi i veprimtarisë së tij letrare apo vendi i tij në letërsinë e sotme shqiptare, por thjesht shprehje e një mendimi ndryshe që ka të bëjë me restaurimin apo jo të shtëpisë së tij të banimit, apo duhet kërkuar solucion tjetër edhe më të përshtatshëm për ta nderuar këtë kolos të letrave shqipe.

Në kohë të fundit ka shumë shkrime dhe kronika televizive sensibilizuese për restaurimin e shtëpisë së banimit të Homerit shqiptar, në Fishtë të Zadrimesë. Kjo çështje është trumbetuar me të madhe edhe nga mërgimtarët tanë në botën e jashtme e sidomos në SHBA, duke lëshuar një lum akuzash në drejtim të autoriteteve përkatëse për çështjen në fjalë. Ka zëra që mendojnë se, në vendin e lindjes, jo larg shtëpisë ku Fishta është rritur, në rrënojat e kalbëzuara të ringrihet një kompleks për poetin tonë. Autoritetet shtetërore duke mos pasur rreth kësaj çështje një përgjigje të përshtatshme, kanë zgjedhur të paktën publikisht, rrugën e heshtjes.

I interesuar rreth çështjes në fjalë, bëra një vizitë në Fishtë dhe nga takimet që pata me persona të autorizuar, mësova se shtëpia e banimit tani për tani, është peng i fisit të Atë Gjergj Fishtës të cilët kërkojnë të dëmshpërblehen me para të majme për t'ia dhënë në dispozicion të kulturës shqiptare shtëpinë në fjalë. Me atë rast vizitova dhe rrënojat e shtëpisë së lindjes së Fishtës, edhe atje ka kërkesa nga nipat dhe stërmipat, për dëmshpërblim. E po, jetojmë me këtë paradoks shqiptar!

A duhet gjetur një rrugëdalje në këtë katrahurë? A duhet përdorur urtia e Solomonit? Unë mendoj se po! Me këtë rast zgjidhja më e mirë, madje dhe më frytdhënëse do ishte duke zgjeruar gamën e personaliteteve françeskanë që kanë kontribuar shumë për popullin tonë.

Jo larg fshatit Fishtë, gjendet kuvendi i Troshanit i ndërtuar në vitin 1880, nga misionaret: At Mariano Pizzochini prej Palmano-va, (Udine) dhe At Gian Pjero Ferrari, prej Bergamo. Duke qenë të nxitur nga porosia papnore për edukimin e brezave të rinj, nga ky Kolegj, u nxor pas pesë viteve shkollim, gjenerata e parë, prej gjashtë nxënësve shqiptarë, të cilët në vitin 1886, qenë dërguar për studime të mëtejshme, në Bosnje për t'u bërë meshtar të urdhrit Françeskan.

Dallëndyshtet e para që fluturuan nga Shkodra për në rishtari (noviciat) në Guçja Gora, afër qytetit



Kuvendi i Troshanit sot...

# Qendër kulturore shtëpia e Fishtës apo Kuvendi i Troshanit?

A ka ndonjë alternativ tjetër për ta nderuar Fishtën, dhe për të shmangur debatet dhe interesat që përplasen në rastin e shtëpisë së poetit?



Shtëpia e banimit Gjergj Fishtës

të Travnikut, sipas dok. 573, dt. 15, tetor, 1886, ishin: vëlla, Anton Nënshati me emrin e pagëzimit, Martin; Jozef Blinishti, me emrin Mëhill; Pjeter Gjadri, me emrin Simon; Lorenc Mitrovic (Mazreku) me emrin Pashko; Engjëll Palçi me emrin Sebastian dhe Gjon (Johannes) Fishta me emrin e pagëzimit, Jozef. Sipas dëshmisë së librit të pagëzuarve të famulhisë së Troshanit, Fishta, që lindur më 22 (e jo me 23)tetor, 1871, e pagëzuar me 24 tetor po të atij viti, me emrin Jozef, nga famullitari i Troshanit, nga Atë Leonardo De Martino. Siç dihet, Fishta në kushtet e Përmotshme, në vitin 1891, nga Jozef e me vonë Johannes (Gjon) kishte marr emrin, Enea-Silvio-Giorgio Fiscta, përkatësisht, Georgius Fiscta.

Në Troshanë të Zadrimes mësuës të Gjergj Fishtës, Shtjefen Gjegovit, Pashko Bardhi, etj. ishte poeti italo-arbëresh, Leonardo De Martino (1830-1823), i cili ngriti poezinë shqiptare në majat më të larta me botimin "Harpa e një Arbëreshi" në vitin 1881 në shqip dhe italisht, etj. Atë Lovro Mihaçević, nga Bosnja (1856-1920), që mësuës i rishtarëve në Troshan dhe rithemelues i Provincës françeskanë shqiptare në vitin 1906. Ai ka shkruar dy vepra të rëndësishme për shqiptarët dhe Shqipërinë: "Nëpër Shqipëri" (1883-1907) Sa-

rajevë 1911 dhe "Shënime nga historia shqiptare", Sarajevë 1912, të botuara në kroatisht dhe gjermanisht. Në Troshan, shkrim leximin në shqip e kishte përforcuar dhe përmbledhësi i Kanunit, Shtjefen Gjegovi; mësuësi i gjuhës shqipe të arbëreshet në Zarë, e më vonë në Shkodër, Atë Pashko Bardhin etj.

Sot Kuvendi i Troshanit si monument historik në vete, është i restauruar dhe i sistemuar më shumë kujdes nga Provinca françeskanë shqiptare. Ka ambiente të brendshme të bollshme dhe shumë të përshtatshme për krijimin e një muzeu përkujtimor për të gjitha këto koka të ndritura françeskanë shqiptare, të cilat aq shumë punuan për popullin tonë sa nuk



Para shtëpisë së Fishtës

dinin në ç'mënyrë do ua kthenim. E në mesin e figurave që do të ndërrohej do ishte poeti Atë Gjergj Fishta.

Mandej, Kuvendi për rreth e qark ka një hapësirë magjepshe dhe atraktive rrëzë vargmaleve të Troshanit. Ka një infrastrukturë të re e solide. Në këtë hapësirë, thënë ndryshe, mund të zhvillohej lirisht një turizëm i suksesshëm kulturor vendas dhe i huaj.

Me këtë rast do shmangej kakovonia e krijuar në mënyrë artificiale dhe autoritetet kulturore do dilnin me kryelartë, sepse krahas "Qendrës Muzeale Ndre Mjeda", do t'i shtohet kulturës shqiptare edhe një Qendër e rëndësishme me figura të merituar nga bota françeskanë.



Kuvendi françeskan i Trashan, 1930